

VENDIM
Nr. 262, datë 6.4.2016

**PËR SHPALLJEN E ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK
NË SPITALLË, DURRËS**

(Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1111, datë 24.12.2020; nr. 580, datë 11.10.2023)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” të territorit me sipërfaqe 49.1 (dyzet e nëntë pikë një) ha, pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, në Spitallë, Durrës, në përbërje të së cilës janë parcelat me numra pasurie, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shtrirja, kufijtë, pikat e hyrjes dhe të daljes së kësaj zone përcaktohen në hartën treguese, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Llojet e veprimtarive që do të zhvillohen në këtë zonë janë:

- a) prodhuese, industriale dhe agropërpunim;
- b) tregtare dhe magazinim mallrash;
- c) shërbime.

4. Periudha e funksionimit të zonës është deri në 99 vjet.

5. Dhënia e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik me qira të bëhet me çmimin simbolik 1 euro.

6. Përzgjedhja e zhvilluesit të bëhet nëpërmjet procedurës konkurruese.

7. Shfuqizuar.

8. Kriteret, në bazë të së cilave vlerësohen zhvilluesit, të jenë:

- a) propozimi i projektit teknik;
- b) ndikimi mjedisor;
- c) ndikimi social;
- ç) kohëzgjatja e punimeve;
- d) kapaciteti financiar i kompanisë dhe mundësia e financimit të projektit.

9. Vendimi nr. 666, datë 29.7.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e e zonës teknologjike të zhvillimit ekonomik, në Spitallë, Durrës”, i ndryshuar, shfuqizohet.

10. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

(Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1111, datë 24.12.2020)

LISTA E PASURIVE QË DO TË PËRFSHIHEN NË “ZONËN E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK” SPITALLË, DURRËS

(Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1111, datë 24.12.2020; Hequr pika 2 dhe 3 në tabelë me VKM-në nr. 580, datë 11.10.2023)

Nr.	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m ²
1	8,517	78	Arë	146,640
2	8,517	79/1	Arë	99,770
3	8,517	80/1	Arë	104,580 ¹
4	8,517	81	Arë	140,400
	TOTAL			491,390

LISTA E PASURIVE QË DO TË PËRFSHIHEN NË “ZONËN E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK” SPITALLË, DURRËS

(Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1111, datë 24.12.2020; nr. 580, datë 11.10.2023)

Nr.	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m ²
1	8,517	78	Arë	146,640
2	8,517	79/1	Arë	99,770
3	8,517	80/1	Arë	104,580
4	8,517	81	Arë	140,400
	TOTAL			491,390

¹ Vendimi nr. 580, datë 11.10.2023 botuar ne F.Z nr. 149, datë 13.10.2023 në pikën 3 të tij shprehet se: “3. Në listën e pasurive që përfshihen në sipërfaqen e zonës teknologjike dhe zhvillimit ekonomik, bashkëlidhur vendimit nr. 262, datë 6.4.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitallë, Durrës”, të ndryshuar, hiqen pronat shtetërore të përcaktuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”